



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/137

Datë: 03.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2013, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e rasteve të zyrtarëve policor të cilët vdesin në detyrë apo kryerje të detyrës.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme që ndikimet buxhetore shtesë për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi t'i ndaj ndajë nga kursimet e brendshme dhe në kuadër të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2013-2016.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/137

Datë: 03.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2013, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë.
2. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenie Sociale dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/137

Datë: 03.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2013, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për hartimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-102
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/137

Datë: 03.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2013, mori:

**V E N D I M**

1. Konfirmohet vendimi i Komitetit Drejtues Ndërministror për Projektin e Zhvillimit të Brezovicës (KDNM), me nr. 02/2013, i datës 25.01.2013 për miratimin e Hapësirës për Zhvillimin e Qendrës Turistike të Brezovicës, të bashkëngjitur si Shtojca I. e këtij vendimi.
2. Plani Hapësinor për zhvillimin e Qendrës Turistike të Brezovicës do të aprovohet nga Qeveria dhe do ti dërgohet Kuvendit të Kosovës.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës përsërit mbështetjen dhe zotimin e plotë për zbatimin e Projektit për Zhvillimin e Qendrës Turistike të Brezovicës, me qëllim të zhvillimit të një qendre turistike malore: për përdorim të shumëllojshëm, me aktivitete gjatë gjithë vitit dhe e klasit botëror, në pajtim me objektivat zhvillimore të miratuara me Vendimin e KDNM-së, Nr. 04/2013 të datës 25.01.2013.
4. Obligohen KDNM, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Integritimeve Evropiane si dhe të gjitha ministrinë dhe organet tjera qeveritare që të lehtësojnë zbatimin e këtij vendimi, dhe të gjitha veprimeve të ndërlydhura për zhvillimin dhe zbatimin e Projektit për Zhvillimin e Qendrës Turistike të Brezovicës, në pajtim me ligjet e aplikueshme.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

---

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/137

Datë: 03.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2013, mori:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 05/120, të datës 25.03.2013**

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr. 05/120, i datës 25.03.2013, ku Qeveria e Republikës së Kosovës merr përgjegjësitë e plota për marrjen e Aeroportit Ushtarak të Gjakovës, me rastin e transferimit nga Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Italisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës si në vijim: pika 2.1 e vendimit zëvendësohet me këtë tekst: Zëvendëskryeministrja për Ekonomi, Kryesuese. Dhe Pas pikës 2.11 shtohet edhe një pikë si 2.12 me këtë tekst: Kontrolli Ajror i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" anëtar.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/137

Datë: 03.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2013, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare për vitin 2014.
2. Agjencia e Statistikave të Kosovës është e obliguar që pjesën e implikimeve financiare të këtij Plani ta harmonizoj me Ligjin për Buxhetin e vitit 2014.
3. Obligohet Agjencia e Statistikave të Kosovës, për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/137

Datë: 03.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2013, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti Vjetor i Agjencisë së Statistikave për zbatimin e planit, programit dhe shfrytëzimin e mjeteve buxhetore vitin 2012.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/137

Datë: 03.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2013, mori:

**V E N D I M**

1. Z. Fidaim Sahiti, emërohet Kryeshf Ekzekutiv në Institutin Gjeologjik të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/137

Datë: 03.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 dhe 5 të Ligjit Nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2013, mori:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në cilësinë e ushtruesit të ligjshëm të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në Ndërmarrjen Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut SH.A. "KOSTT", vendos se Ministri i Financave, autorizohet dhe urdhërohet të veprojë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si aksionar i vetëm në KOSTT, dhe të ndërmarrë të gjitha masat e ligjshme, të nevojshme dhe të përshtatshme të aksionarit për realizimin e veprimit në vijim në periudhën më të shkurtër kohore të mundshme ligjërisht:
  - 1.1. Të kërkojë nga KOST dhe Bordi i saj i Drejtorëve që menjëherë të deklarojnë dhe paguajnë një dividendë për aksionarin në shumën prej tre milion (3,000,000) euro.
2. Obligohet Ministri i Financave që në bashkëpunim me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik dhe Bordin e Drejtorëve të KOSTT Sh.A. të caktojë dinamikën e ekzekutimit të obligimit nga pika 1.1. të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/137

Datë: 03.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2013, mori:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 700,000.00 euro për mbulimin e shpenzimeve për të gjithë përfaqësuesit e Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive që marrin pjesë në delegacionet e bisedimeve.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga kodi 232, shpenzimet e paparashikuara, kategoria ekonomike -Rezervat, në shumë prej 350,000.00 euro dhe nga kursimet e secilës Ministri në shumë prej 18,421.00 euro nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.
3. Mjetet financiare nga pika 1. bartën në Zyrën e Kryeministrit, në nën-programin me kod 107, Kabineti i Kryeministrit në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime.
4. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi mbulojnë shpenzimet që kanë ndodhur deri më tani dhe ato që pritet të ndodhin në procesin e bisedimeve nga delegacioni kosovar.
5. Obligohen ministrinë e ndikuara nga ky vendim që pas 7 dite nga aprovimi i këtij vendimi të paraqesin kursimet nga pika 2. e këtij vendimi në Ministrinë e Financave.
6. Obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave dhe Ministrinë e ndikuara për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/137

Datë: 03.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2013, mori:

**V E N D I M**

1. Për Inicimin e procedurës së shpalljes të korridoreve të rrugëve me rendësi nacionale.
2. Korridoret e Rrugëve Nacionale Prishtinë - Mitrovicë - Leposaviq, Prishtinë - Pejë, Ferizaj - Gjilan - Dheu i Bardhë - Kufiri me Serbinë dhe Rruga Rajonale Deçan-Kufiri me Malin e Zi (drejtimi Plavë), të shpallen si korridore me interes nacional.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 12/137

Datë: 03.07.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2013, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa Shoqatës së Invalidëve të Luftës të UÇK-së, Shoqatës të Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së dhe Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së, për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 500,000.00 euro për ndihmë për rregullimin e protezave për invalidët, dhe rehabilitim.
  - 1.1. Shoqatës së Invalidëve të Luftës i ndahen gjithsej 125,000.00 euro për rehabilitim, dhe 200,000.00 për shërim dhe proteza. Mjetet transferohen në xhirollogarinë e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, nr. 1110-003683-0001-63, në bankën komerciale Pro Credit Bank.
  - 1.2. Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve i ndahen 55,000,00 euro për rehabilitim, mjetet transferohen në xhirollogarinë e SHFD të UÇK-së, nr. 1110 270777000187 në bankën komerciale Pro Credit Bank.
  - 1.3. Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së i ndahen 120,000.00 euro për rehabilitim, mjetet transferohen në xhirollogarinë e OVL të UÇK-së - NLB Prishtina nr. 170 100 1010 734491.
2. Mjetet financiare në vlerë prej 400,000.00 euro nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga kodi 232-shpenzimet e paparashikuara, kategoria ekonomike - Rezerva, si vijon:
  - Shoqatës së Invalidëve të Luftës i ndahen gjithsej 325,000.00 euro, nga të cilat: 125,000 për rehabilitim dhe 200,000 euro për shërim dhe proteza,
  - Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve i ndahen 55,000,00 euro
  - Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së i ndahen 20,000.00 euro

3. Mjetet financiare në vlerë prej 100,000.00 euro nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, nën-programi Trajnimi Profesional me kod 912 kategori ekonomike subvencione e transfero, dhe transferohen nga buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenës Sociale në xhironlogarinë e OVL të UÇK-së -NLB Prishtina nr. 170 100 1010 734491
4. Mjetet nga Pikat 2. transferohen përmes Departamentit të thesarit të Ministrisë së Financave në xhironlogaritë e shoqatave në pajtim me paragrafët 1.1., 1.2. dhe 1.3. të pikës 1. të këtij vendimi, ndërsa nga pika 3 nga Ministria e punës dhe Mirëqenës Sociale.
5. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

---

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë